

20120541541

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 27 dhe 47 paragrafi 1 pika 6 nga Ligji për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

VENDIM PËR TËRHEQJEN NGA QARKULLIMI TË MONEDHAVE ME VLERË NOMINALE 50 DENI

1. Monedhat me vlerë nominale 50 deni (emetim I/93), tërhiqen nga qarkullimi, duke i këmbyer ato falas me kartëmonedha dhe monedha të tjera në shumë ekuivalente.

2. Monedhat nga paragrafi 1 i këtij vendimi, pushojnë së qenuri mjet ligjor për pagesë nga data 01.01.2013.

3. Monedhat nga paragrafi 1 i këtij vendimi do të këmben nga data 01.01.2013 deri më datë 31.03.2013.

Këmbimi do të bëhet nga bankat e themeluara në Republikën e Maqedonisë.

4. Nga data 01.04.2013, këmbimi i monedhave nga paragrafi 1 i këtij vendimi do të kryhet në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë.

5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga shpallja në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" dhe do të zbatohet nga data 01.01.2013.

Nr.V. 02-15/V-3/2012
26 prill viti 2012
Shkup

Guvernator dhe Kryetar
i Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë
Dimitar Bogov